

PROCESVERBAL
nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për
shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e mbajtur
më 16.03.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit në ASHMA, Selver Ajdini zëvendës i kryetarit të Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski , dr.Metodija Jançeski .

Anëtarët që mungojnë në Këshillin e Agjencisë : /

Në seancë nuk ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (në pushim vjetor).

Udhëheqësja e sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shefe e kabinetit mr. Dragica Ljubevska, e zëvendësonte drejtorin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale sipas autorizimi nr.03 - 4932 / 1 nga 31.12.2021

Të pranishëm nga shërbimi profesional : mr.Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë:

Z.Petrushevski e hapi seancën e 10-të të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Seanca filloi në ora 12:15 dhe u mbajtë në ambijentet e Agjencisë, në sallën e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë , miratoi njëzëri si në vijim :

RENDI I DITËS

1.Miratim i Propozim – procesverbalit nga seanca e 1-rë publike e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, e mbajtur më 10.03.2022

2.Miratim i Propozim – procesverbali nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, e mbajtur më 10.03.2022

3.Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për marrjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë tregtare të transmetuesit RADIO LA KOSTA SHPKPV Vinicë nr.08-93 nga 05.01.2015

4. Të ndryshme .

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga Seanca e 1-rë Publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 10 mars 2022, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 10 mars 2022, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahje të punës së drejtorit dhe këshillit - shefe e kabinetit, mr. Dragica Ljubevska, ka arsyetuar Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për marrjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë tregtare të transmetuesit RADIO LA KOSTA SHPKPV Vinicë. nr.08-93 nga 05.01.2015. Ka shpjeguar se në seancën e 8-të e mbajtur më 03.03.2022, Këshilli i Agjencisë ka iniciuar procedurë për marrjen e licencës për transmetim në radio të këtij transmetuesi për shkak se nuk e ka paguar tarifën vjetore në afatin e paraparë, përkatësisht 30 ditë nga dita e pranimi të faturës që Agjencia e ka lëshuar. Lidhur me këtë, Agjencia e njoftoi transmetuesin se nëse nuk e pagon shumën e kërkuar, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit për fillimin e procedurës do t'ia marrë lejen për radio transmetim. Më 14.03.2022 transmetuesi ka bërë pagesën në shumë prej 11.288,00 denarë, duke paguar në tërësi tarifën vjetore për lejen për transmetim. Për këtë arsye Këshillit i është dorëzuar propozim për ndërprerjen e procedurës së nisur.

Z. Petrushevski tha se është një lajm pozitiv që ky transmetues ka arritur të paguajë mjetet. Shprehu shpresën se vitin e ardhshëm do të jetë në gjendje më të mirë financiare dhe nuk do të vijë më në një situatë të tillë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendimin për pezullimin e procedurës së inicuar për marrjen e lejes për radio transmetim të SHTR RADIO LA KOSTA SHPKPV Vinicë, nr. 08-93 nga 05.01.2015.

Me datën 14.03.2022, transmetuesi në fjalë ka kryer pagesën në shumë prej 11.288,00 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) denarë, duke paguar në tërësi tarifën vjetore për lejen e radio transmetimit.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit vendimin e sipërpërmendur të shpallë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-999/3
18.03.2022
Sh k u p

Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI d.v